



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA E RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR LEZHË
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR KUKËS

Kukës, më 25.08.2026

NJOFTIM PËR ZHVILLIMIN E PRAKTIKËS PROFESIONALE PËR PERIUdhËN I, VITI
MËSIMOR 2026-2027

Në zbatim të ligjit nr.69/2012, datë 21.06.2012, *Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*, të ndryshuar, ligjit nr.10171, datë 22.10.2009, *Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë*, i ndryshuar, udhëzimit nr.14, datë 10.07.2023, *Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arimorë në institucionet e arsimit parauniversitar dhe urdhrit nr.100, datë 25.02.2022, Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit"*, i ndryshuar, si dhe shkresës me Nr. 2298 Prot, datë 21.08.2026, *Për zhvillimin e praktikës profesionale në profesionin e rregulluar të mësuesit për vitin mësimor 2026-2027.*

Kohëzgjatja e praktikës profesionale që kryhet nga praktikanti është një periudhë mësimore (3 muaj), Shtator-Dhjetor.

Procesi i aplikimit për të kryer praktikën profesionale për profesionin e regulluar të mësuesit për vitin shkollor 2026-2027 do të bëhet vetëm online në portalin E- Albania.

Kandidatet e interesuar për të zhvilluar praktiken në periudhën e parë mund të regjistrohen në portal nga data 26.08.2026 deri më 04.09.2026, deri në ora 24:00.

Kandidatet që aplikojnë për Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Kukës duhet të jenë banorë të Bashkisë Kukës

Kandidatët duhet të ngarkojnë me korrektësi gjithë dokumentacionin e kërkuar si më poshtë vijon:

- 1- CV e kandidatit për praktikë profesionale
- 2- Dokumenti i identifikimit (Kartë Identiteti)
- 3- Diplomë Bachelor me listë notash dhe Master i mësuesisë "Profesional" ose "Shkencor" me listë notash (skanimit nga origjinali)
Në mungesë të diplomës Master, kandidati/ja duhet të ngarkojë vërtetimin (skanim origjinal), të marrë nga sekretaria e fakultetit përkatës të vitit aktual ku të citohet:
 - *Data e diplomimit
 - *Numri i matrikullimit
 - *Të theksohet në vërtetim se kandidati/ja ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj fakultetit.
- 4- Raporti mjeko-ligjor
- 5- Vërtetim nga prokuroria
- 6- Vërtetim nga gjykata
- 7- Dëshmi penaliteti
- 8- Vërtetim banimi

DREJTOR

KRESHNIK GËRBOLLI